# ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

**Për Aktivitetin e Prokurimit:**

| | |
|---|---|
| **Nr[1] i prokurimit** | **328-25-10922-5-1-1** |
| **Nr i brendshëm** | **33300/25/034/511** |

**Sa i përket tenderit për: "Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë".**

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit*

***EBK SH.P.K&ULEZA NDERTIM SHPK***
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

***Rruga:Bujar Godeni p.n. - Prizren***

*(Adresa)*

***Prizren*** — *20000*

*(Vendi)* — *(Kodi postar)*

***049/509-237*** — *N/A*

*(Numri Telefonit)* — *(Numri i Faks-it)*

***Flamur Shefiku***

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

***ebkosova@gmail.com***
*(Adresa elektronike)*

***04.05.2026***
*(Data e parashtrimit të ankesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. EBK

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

### 2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_______________________________________________

*(Emri i avokatit)*

_______________________________________________

*(Adresa e plotë)*

______________________ ______________________

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

______________________

*(Adresa elektronike)*

______________________ ______________________

*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

| |
|---|
| Njoftimi për kontratë 04.12.2025<br>Njoftimi mbi vendimin e AK: 16.04.2026<br>Kërkesa për rishqyrtim: 21.04.2026<br>Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 22.04.2026 |

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 1 i LPP-së**
**Neni 7 i LPP-së**
**Neni 52 i LPP-së**
**Neni 56 i LPP-së**
**Neni 59 i LPP-së**
**Neni 60 i LPP-së**
**Neni 68 i LPP-së**
**Neni 69 i LPP-së**
**Neni 72 i LPP-së**
**Neni 40 i RRPP Nr.001/2022.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Njoftimi për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit është publikuar me dt.04.12.2025, procedurë e hapur, kontratë pune me vlerë të madhe.
Në këtë tender kanë ofertuar gjithsejtë tetë operator ekonomik.
Njoftimi mbi vendimin është publikuar me dt.16.04.2026, ndërsa aktiviteti i prokurimit në fjalë është anuluar me arsyetimin se nuk ka ofertues të përgjegjshëm.

Arsyeja e eliminimit për grupin tonë ofertues është dhënë si më poshtë:

**Autoriteti kontraktues ne dosje te tenderit te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare | 8.1 & 8.2 | **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **Operatori Ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik ose grupit te operatoreve ekonomik , gjatë tre viteve të fundit ( 2022, 2023, 2024) ka qenë prej jo më pak se 10,000,000.00 euro, Lideri 60%.** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Deklaratat Tatimore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e shkuara ( 2022, 2023, 2024) ose Vërtetim të shkarkuar nga platforma e ATK-së mbi qarkullimin financiar në tri vitet e shkuara ose gjendje e përgjithshme të vlerësuar dhe vërtetuar nga ATK** |

**Komisioni i vlerësimit pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, është konstatuar se lideri i konsorciumit nuk e plotëson kriterin e kërkuar në Dosjen e Tenderit lidhur me kapacitetin ekonomik dhe financiar.**

**Sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit, lideri duhet të dëshmojë se ka realizuar së paku 60% të qarkullimit të kërkuar për tri vitet e fundit. Nga dokumentet e paraqitura, rezulton se ky kusht nuk është përmbushur nga lideri i konsorciumit.**

**Në përputhje me këtë, oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme.**

Lidhur me kriterin e kërkuar, në ofertë kemi bashkangjitur formularët e deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave nga ATK edhe për liderin EBK SHPK, mirëpo në këta formularë vlerat janë të shënuara pa TVSH, prandaj nëse këto vlera i ka marr për bazë autoriteti kontraktues, atëherë sqarojmë se kësaj vlere duhet ti shtohet edhe TVSH dhe të përllogaritet në kuadër të vlerës së qarkullimeve vjetore, në të kundërtën nuk kemi të bëjmë me një vlerësim real të gjendjes financiare të operatorit ekonomik EBK SHPK.

Duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit, vlerësojmë se është kërkuar qarkullimi financiar gjatë tri viteve të fundit, prandaj qarkullimet financiare përfshijnë edhe TVSH e cila është pjesë reale financiare, prandaj mbi këtë bazë konsiderojmë se duhet të merren parasysh qarkullimet financiare me TVSH të cilat e dëshmojnë qarkullimin total, ose më thjesht, kërkojmë që qarkullimit përmes ATK-së ti shtohet edhe TVSH-ja dhe të merret për bazë kjo vlerë e përgjithshme.

Edhe pse kërkesa për qarkullim financiar është kërkuar nga ATK-ja, nuk është specifikuar decidivisht se qarkullimi duhet të vlerësohet pa TVSH, prandaj një interpretim i tillë nga AK-ja do të ishte në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit dhe do të ishte interpretim i njëanshëm dhe subjektiv, i cili do të dëmtonte padrejtësisht ankuesin në këtë rast.

Po ashtu veprimi AK-së për eliminim të grupit tonë ofertues bie në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, pasi që i bie se jemi eliminuar për një kërkesë që nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit.

Qëllimi i kërkesës për qarkullim financiar, është që të vlerësohet nëse tenderuesi ka stabilitetin e mjaftueshëm financiar dhe ekonomik për të përformuar kontratën e propozuar, prandaj ne e kemi këtë stabilitet dhe e mbulojmë kërkesën për gjendjen ekonomiko financiare, prandaj edhe në këtë rast po vërtetohet se me dëshmitë e ofruara nga ne, plotësohet kërkesa e dosjes së tenderit dhe konfirmohet se ne kemi stabilitet financiar.

Edhe pse sa i përket vlerësimit për mundësi të sigurimit të kryerjes së punimeve, para nënshkrimit të kontratës kërkohet sigurimi i ekzekutimit të kontratës me qëllim të përforcimit të sigurisë për mos dështim në implementim të kontratë.
Kompania EBK SHPK ka performancë shumë të mirë në kryerjen dhe finalizimin e kontratave duke mos dështuar asnjëherë në kontrata publike e private, prandaj edhe ka qarkullime financiare të cilat dëshmojnë edhe për stabilitet financiar.
Nëse do të ishte e shënuar në dosje të tenderit se qarkullimet financiare duhet të dëshmohen pa TVSH, atëherë ne, me siguri që do të bënim një zgjidhje tjetër për të marr në grup (si lider) edhe ndonjë kompani tjetër për të plotësuar qarkullimin financiar pa TVSH, sepse ne kemi bashkëpunime të shumta me kompani të ndryshme.
Për shkak të paqartësive eventuale të kërkesës ose të mangësive që përmban kërkesa, nuk duhet të pësojnë operatorët ekonomik, prandaj përderisa nuk është e cekur se qarkullimi duhet të ofrohet pa TVSH, atëherë rezulton se ne jemi eliminuar pa të drejtë në këtë aktivitet të prokurimit.
Nëse ka pasur ndonjë dilemë autoriteti kontraktues është dashur të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, qoftë drejtpërdrejtë nga ne ose edhe nga administrata tatimore e Kosovës.
**Sa për sqarim çështjen e TVSH-së po e elaborojmë me fakte për tri vitet si më poshtë:**

- **Për vitin 2024 Qarkullimi NETO (pa TVSH) është 2,869,524.87 € (sipas Formularit CD)**
- **Totali i TVSH-së së deklaruar: 516,514.48 €**
  **(sipas deklaratave mujore të TVSH-së)**
- **QARKULLIMI BRUTO**
- **Në bazë të të dhënave të sipërpërmendura:**
- **QARKULLIMI TOTAL BRUTO (përfshirë TVSH) është: 3,386,039.35 €**

Në bazë të të dhënave të sipër përmendura, Deklarojmë se:
• Të gjitha të dhënat e paraqitura janë të sakta dhe të bazuara në dokumentacion zyrtar tatimor
• Qarkullimi bruto është kalkuluar duke përfshirë TVSH sipas deklarimeve mujore, për shkak se formulari CD pasqyron vetëm vlerat neto (pa TVSH).

## SHTOJCA 1 – PASQYRË MUJORE E TVSH-SË

| Muaji | [9] Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi | [10] Shitjet e liruara me të drejtë kreditimi | [11] Eksportet | [12] Shitjet e tatueshme me normën 18% | [13] TVSH 18% | [14] Shitjet e tatueshme me normën 8% | [15] TVSH 8% |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | - | - | - | 1,353.47 | 243.62 | - | - |
| Shkurt | - | - | - | 196,268.72 | 35,328.37 | - | - |
| Mars | - | - | - | 177,201.90 | 31,896.34 | - | - |
| Prill | - | - | - | 83,956.36 | 15,112.14 | - | - |
| Maj | - | - | - | 84,672.34 | 15,241.02 | - | - |
| Qersh | - | - | - | 168,541.71 | 30,337.51 | - | - |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| or | | | | | | | |
| Korrik | - | - | - | 158,989.57 | 28,618.12 | - | - |
| Gusht | - | - | - | 266,607.71 | 47,989.39 | - | - |
| Shtator | - | - | - | 285,060.34 | 51,310.86 | - | - |
| Tetor | - | - | - | 233,617.87 | 42,051.22 | - | - |
| Nëntor | - | - | - | 534,532.27 | 96,215.81 | - | - |
| Dhjetor | - | - | - | 678,722.61 | 122,170.07 | - | - |
| TOTALI VJETOR | - | - | - | 2,869,524.87 | 516,514.48 | - | - |

## SHTOJCA 2 – PËRMBLEDHJA VJETORE E TVSH-SË

| Përshkrimi | Vlera Vjetore (€) |
|---|---|
| [9] Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi | - |
| [10] Shitjet e liruara me të drejtë kreditimi | - |
| [11] Eksportet | - |
| [12] Shitjet e tatueshme me normën 18% | 2,869,524.87 |
| [13] TVSH 18% | 516,514.48 |
| [14] Shitjet e tatueshme me normën 8% | - |
| [15] TVSH 8% | - |
| | 3,386,039.35 |

**Shënim:**
Të dhënat janë të bazuara në deklarimet mujore të TVSH-së të dorëzuara pranë Administrata Tatimore e Kosovës.

Bashkangjitur me këtë ankesë keni edhe Formularin e Deklarimit të TVSH-së për 12 muajt e vitit 2024 dhe CD përkatësisht FORMULARI I DEKLARIMIT VJETOR DHE PAGESES PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE, ku përputhen plotësisht të dhënat dhe shifrat e lartcekura.
Këto janë dëshmi konkrete për qarkullimin financiar për vitin 2024 për kompaninë EBK SHPK.

- **Për vitin 2023 Qarkullimi NETO (pa TVSH) është 1,242,831.00 € (sipas Formularit CD)**
- Totali i TVSH-së së deklaruar: **223,709.58 €**
  (sipas deklaratave mujore të TVSH-së)
- QARKULLIMI BRUTO

- Në bazë të të dhënave të sipërpërmendura:
  QARKULLIMI TOTAL BRUTO (përfshirë TVSH) është: **1,466,540.58 €**

Në bazë të të dhënave të sipër përmendura, Deklarojmë se:

- Të gjitha të dhënat e paraqitura janë të sakta dhe të bazuara në dokumentacion zyrtar tatimor
- Qarkullimi bruto është kalkuluar duke përfshirë TVSH sipas deklarimeve mujore, për shkak se formulari CD pasqyron vetëm vlerat neto (pa TVSH).

## SHTOJCA 1 – PASQYRË MUJORE E TVSH-SË

| Muaji | [9] Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi | [10] Shitjet e liruara me të drejtë kreditimi | [11] Eksportet | [12] Shitjet e tatueshme me normën 18% | [13] TVSH 18% | [14] Shitjet e tatueshme me normën 8% | [15] TVSH 8% |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | - | - | - | 1,353.47 | 243.62 | - | - |
| Shkurt | - | - | - | 129,069.36 | 23,232.48 | - | - |
| Mars | - | - | - | 1,353.47 | 243.62 | - | - |
| Prill | - | - | - | 35,251.78 | 6,345.32 | - | - |
| Maj | - | - | - | 254,442.23 | 45,799.60 | - | - |
| Qershor | - | - | - | 79,586.10 | 14,325.50 | - | - |
| Korrik | - | - | - | 3,322.11 | 597.98 | - | - |
| Gusht | - | - | - | 69,150.08 | 12,447.01 | - | - |
| Shtator | - | - | - | 94,191.57 | 16,954.48 | - | - |
| Tetor | - | - | - | 126,314.08 | 22,736.53 | - | - |
| Nëntor | - | - | - | 221,838.47 | 39,930.92 | - | - |
| Dhjetor | - | - | - | 226,958.28 | 40,852.49 | - | - |
| **TOTALI VJETOR** | **-** | **-** | **-** | **1,242,831.00** | **223,709.58** | **-** | **-** |

## SHTOJCA 2 – PËRMBLEDHJA VJETORE E TVSH-SË

| Përshkrimi | Vlera Vjetore (€) |
|---|---|
| [9] Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi | - |
| [10] Shitjet e liruara me të drejtë kreditimi | - |
| [11] Eksportet | - |
| [12] Shitjet e tatueshme me normën 18% | **1,242,831.00** |
| [13] TVSH 18% | **223,709.58** |
| [14] Shitjet e tatueshme me normën 8% | - |
| [15] TVSH 8% | - |

1,466,540.58

**Shënim:**
**Të dhënat janë të bazuara në deklarimet mujore të TVSH-së të dorëzuara pranë Administrata Tatimore e Kosovës.**

Bashkangjitur me këtë ankesë keni edhe Formularin e Deklarimit të TVSH-së për 12 muajt e vitit 2023 dhe CD përkatësisht FORMULARI I DEKLARIMIT VJETOR DHE PAGESES PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE, ku përputhen plotësisht të dhënat dhe shifrat e lartcekura.
Këto janë dëshmi konkrete për qarkullimin financiar për vitin 2023 për kompaninë EBK SHPK.

- **Për vitin 2022 Qarkullimi NETO (pa TVSH) është 977,002.46 € (sipas Formularit CD)**
- Totali i TVSH-së së deklaruar: **175,860.44 €**
  (sipas deklaratave mujore të TVSH-së)
- QARKULLIMI BRUTO
- Në bazë të të dhënave të sipërpërmendura:
  QARKULLIMI TOTAL BRUTO (përfshirë TVSH) është: **1,152,862.90 €**

Në bazë të të dhënave të sipër përmendura, Deklarojmë se:

- Të gjitha të dhënat e paraqitura janë të sakta dhe të bazuara në dokumentacion zyrtar tatimor
- Qarkullimi bruto është kalkuluar duke përfshirë TVSH sipas deklarimeve mujore, për shkak se formulari CD pasqyron vetëm vlerat neto (pa TVSH).

## SHTOJCA 1 – PASQYRË MUJORE E TVSH-SË

| Muaji | [9] Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi | [10] Shitjet e liruara me të drejtë kreditimi | [11] Eksport et | [12] Shitjet e tatueshme me normën 18% | [13] TVSH 18% | [14] Shitjet e tatueshme me normën 8% | [15] TVSH 8% |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | - | - | - | 38,217.88 | 6,879.22 | - | - |
| Shkurt | - | - | - | 31,692.45 | 5,704.64 | - | - |
| Mars | - | - | - | 42,725.93 | 7,690.67 | - | - |
| Prill | - | - | - | 1,353.47 | 243.62 | - | - |
| Maj | - | - | - | 41,177.79 | 7,412.00 | - | - |
| Qershor | - | - | - | 1,353.47 | 243.62 | - | - |
| Korrik | - | - | - | 175,052.21 | 31,509.40 | - | - |
| Gusht | - | - | - | 46,469.41 | 8,364.49 | - | - |
| Shtator | - | - | - | 116,571.36 | 20,982.84 | - | - |
| Tetor | - | - | - | 217,898.38 | 39,221.71 | - | - |
| Nëntor | - | - | - | 135,566.09 | 24,401.90 | - | - |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Dhjetor | - | - | - | 128,924.02 | 23,206.32 | - | - |
| **TOTALI VJETOR** | **-** | **-** | **-** | **977,002.46** | **175,860.44** | **-** | **-** |

## SHTOJCA 2 – PËRMBLEDHJA VJETORE E TVSH-SË

| Përshkrimi | Vlera Vjetore (€) |
|---|---|
| [9] Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi | - |
| [10] Shitjet e liruara me të drejtë kreditimi | - |
| [11] Eksportet | - |
| [12] Shitjet e tatueshme me normën 18% | **977,002.46** |
| [13] TVSH 18% | **175,860.44** |
| [14] Shitjet e tatueshme me normën 8% | - |
| [15] TVSH 8% | - |
| | **1,152,862.90** |

**Shënim:**
**Të dhënat janë të bazuara në deklarimet mujore të TVSH-së të dorëzuara pranë Administrata Tatimore e Kosovës.**

Bashkangjitur me këtë ankesë keni edhe Formularin e Deklarimit të TVSH-së për 12 muajt e vitit 2022 dhe CD përkatësisht FORMULARI I DEKLARIMIT VJETOR DHE PAGESES PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE, ku përputhen plotësisht të dhënat dhe shifrat e lartcekura.
Këto janë dëshmi konkrete për qarkullimin financiar për vitin 2024 për kompaninë EBK SHPK.

Në bazë të analizës dhe përllogaritjeve të qarkullimit financiar me TVSH për tri vitet e fundit, rezulton se lideri EBK SHPK ka qarkullim në vlerë prej:**6,005,442.83 euro**, e që rezulton se plotësohet kërkesa prej 60 % të vlerës së kërkuar të 10,000,000.00 euro.
Autoriteti kontraktues nuk ka shpreh gatishmëri fare për të sqaruar dëshminë për të cilën jemi eliminuar por në mënyrë restriktive dhe të ngushtë ka interpretuar dëshmitë e ATK-së, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që të analizohen në detaje dëshmitë e ofruara nga ne dhe të merret parasysh edhe TVSH në kuadër të qarkullimit financiar në të kundërtën, ne po dëmtohemi në këtë proces të prokurimit.

Kur kem parasysh sqarimet e lartcekura, vijmë në përfundim se ne jemi ofertues i përgjegjshëm, prandaj kur kem parasysh dëshmitë e ofruara me dosje të tenderit si dhe faktin se të gjithë ofertuesit tjerë janë të papërgjegjshëm atëherë ne është dashur të rekomandohemi për kontratë.
Nëse eventualisht, autoriteti kontraktues ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me qarkullimin financiar është dashur të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Të gjithë operatorët tjerë ekonomik ofertues janë të papërgjegjshëm, ashtu siç e ka cek edhe vetë autoriteti kontraktues, prandaj të gjitha arsyet që i ka cek AK-së për këta operator ekonomik janë edhe pretendime tona ankimore, prandaj për të mos i përsëritur pretendimet ankimore, ne veç po i përshkruajmë arsyet e eliminimit të të gjithë operatorëve ekonomik nga autoriteti kontraktues.

- Grupi i OE "**AAG PROJEKT&EURO SERVICES SH.P.K&ALPING SHPK&SHKËMBI SHPK** është i papërgjegjshëm, ndërsa arsyet e eliminimit që janë dhënë nga AK-së për këtë OE janë edhe pretendime tona ankimore, prandaj për të mos i përsëritur ato ne vetëm po i shënojmë ashtu siç i ka shënuar autoriteti kontraktues:

**Komisioni Vlerësues gjatë procesit të korrigjimit të gabimeve aritmetike në ofertën tuaj ka konstatuar se dallimi i identifikuar tejkalon pragun e lejuar prej +/- 2%,**

**Oferta financiare ( çmimi ) e dorëzuar nga ana juaj në vlerë totale prej: 4,509,447.69€**
**Pas korrigjimit nga ana e komisioni vlerësues është: 4,793,959.69 €**

**Në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, neni 40.9 i Rregullores Nr. 001/2022, për prokurim publik komisioni vlerësues do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy se +/- 2%, i vlerës totale të ofertës.**

**Kur korrigjimi i gabimeve aritmetike kalon kufirin prej 2%, oferta konsiderohet e papranueshme dhe refuzohet.**

- OE **LIMIT PROJECT SHPK&RINESA SHPK&DELTA-CCD SHPK&BENITA COMPANY SHPK** është i papërgjegjshëm, ndërsa arsyet e eliminimit që janë dhënë nga AK-së për këtë OE janë edhe pretendime tona ankimore, prandaj për të mos i përsëritur ato ne vetëm po i shënojmë ashtu siç i ka shënuar autoriteti kontraktues.

**Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FTD)**

| | | |
|---|---|---|
| Vlera e parashikuar | Neni 2.4 | **Pesë milionë euro (5,000,000.00 €)** |

Oferta juaj financiare ( çmimi ) në vlerë totale prej: **5,999,137.17€** dorëzuar me date **03.03.2026**, e tejkalojnë buxhetin e planifikuar nga Autoritetit Kontraktues Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës, për aktivitetin e prokurimit **Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, me numër te prokurimit: 328-25-10922-5-1-1, dhe numër te brendshëm 33300/25/034/511,**

- **OE OLTI TRASING SH.P.K është i papërgjegjshëm, ndërsa arsyet e eliminimit që Janë dhënë nga AK-së për këtë OE janë edhe pretendime tona ankimore, prandaj për të mos i përsëritur ato ne vetëm po i shënojmë ashtu siç i ka shënuar autoriteti kontraktues.**

Nuk është plotësuar një pozicion në listën e çmimeve; **Pozicioni 1.3.3.8 Pajisje tjera te imta te pa specifikuara nuk keni vendosur çmim**

**Në disa pozicione si 2.1.15, 2.1.17, 2.1.18, 2.1.19, 2.1.20 është larguar sasia e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.**

Pasi lista e çmimeve duhet të plotësohet në tërësi dhe pa ndryshime në përmbajtje.

Rrjedhimisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, oferta juaj shpallet e papërgjegjshme dhe eliminohet nga procedura e mëtejme e vlerësimit.

**Lista e çmimeve nuk është Plotësuar Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Kusht administrativ**

**Letër standarde për tenderuesin eliminuar, i bashkëngjitet**

**Lista e çmimeve e dorëzuar nga ju.**

- **GOE "ADETEX SH.P.K & ENGINEERING SHPK"** është i papërgjegjshëm, ndërsa arsyet e eliminimit që janë dhënë nga AK-së për këtë OE janë edhe pretendime tona ankimore, prandaj për të mos i përsëritur ato ne vetëm po i shënojmë ashtu siç i ka shënuar autoriteti kontraktues.

**Komisioni vlerësues gjatë procesit të korrigjimit të gabimeve aritmetike në ofertën tuaj ka konstatuar se dallimi i identifikuar tejkalon pragun e lejuar prej +/- 2%,**

**Oferta financiare ( çmimi ) e dorëzuar nga ana juaj në vlerë totale prej: 4,497,775.78 €**
**Pas korrigjimit nga ana e komisioni vlerësues është: 4,820,453.78€**

**Në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, neni 40.9 i Rregullores Nr. 001/2022, për prokurim publik komisioni vlerësues do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy se +/- 2%, i vlerës totale të ofertës.**

**Kur korrigjimi i gabimeve aritmetike kalon kufirin prej 2%, oferta konsiderohet e papranueshme dhe refuzohet.**

- **Grupi i OE "R&RUKOLLI &LIMORA SH.P.K është i papërgjegjshëm, ndërsa arsyet e eliminimit që janë dhënë nga AK-së për këtë OE janë edhe pretendime tona ankimore, prandaj për të mos i përsëritur ato ne vetëm po i shënojmë ashtu siç i ka shënuar autoriteti kontraktues.**

**Autoriteti kontraktues ne dosje te tenderit te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar:**

| | |
|---|---|
| **OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose bachelor me master te Makinerisë, kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune. Te jete i certifikuar për instalimin e sistemeve te gypave tubacioneve te ngrohjes qendrore.** | 1. Mungon -Diploma e Masterit |

| | |
|---|---|
| **OE duhet te dëshmoj se ka një Inxhinier te Diplomuar ose Bachelor me master te Ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv min. 3 vjet përvojë pune. Te jete i trajnuar ne fushën e mbrojtjes nga zjarri .** | 1. Mungon Diploma eMasterit |

**Në kuadër të procesit të vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë" komisioni i vlerësimit ka konstatuar se ju nuk i keni dorëzuar dokumentet e larte cekura siç është kërkuara ne dosje te tenderit.**

1. **Per Inxhinierin Agron Musliu ju nuk e keni dorëzuar kopjen e diplomës se masterit**
2. **Per Inxhinierin Bajram Gjinovci ju nuk e keni dorëzuar kopjen e diplomës se masterit**

- **Gupi i OE NIKA PrO-ING SH.P.K&FUSHA është i papërgjegjshëm, ndërsa arsyet e eliminimit që janë dhënë nga AK-së për këtë OE janë edhe pretendime tona ankimore, prandaj për të mos i përsëritur ato ne vetëm po i shënojmë ashtu siç i ka shënuar autoriteti kontraktues.**

**Autoriteti kontraktues ne dosje te tenderit te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale | 7.1 & 7.2 | **Përshtatshmëria profesionale:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| | | Regjistrimi i numrit fiskal | Kopja certifikatës së numrit fiskal |
| | | Regjistrimi i TVSH-se. | Kopja e certifikatës se TVSH-se |
| | | OE duhet te dëshmoj se ka një Inxhinier te Diplomuar ose Bachelor me master te Gjeodezisë (min.5 vjet provojë pune ), i licencuar sipas legjislacionit në Republikën e Kosovës (AKK). | 1. Certifikat;<br>2. Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës duhet diploma të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës |

**Në kuadër të procesit të vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë", komisioni i vlerësimit ka konstatuar se ju nuk i keni dorëzuar dokumentet e larte cekura për operatorin ekonomik "FUSHA "**

1. Kopja certifikatës së numrit fiskal ,
2. Kopja e certifikatës se TVSH-se ,

Per Inxhinierin Xhavit Fetahu ju nuk e keni dorëzuar nostifikimin e diplomës se masterit dhe Licenca është me afat te skaduar

Per Certifikatën IWS (International Welding Specialist) për saldim; penetrim apo testim visual nga institutet vendore apo ndërkombëtare(PT) dhe
Certifikatën për menaxhimin e kontratave FIDIC si dhe për menaxhimin te kantierit te ndërtimit, Te Inxhinierit Mentor Ibishi duhet te ofroni dëshminë nga institucioni lëshues qe certifikata është autentike dhe e vlefshme dhe te përmbaj kontakt për verifikim

Autoriteti Kontraktues (AK) ka të drejtën të verifikojë duke filluar nga: Adresa e furnizimit te pajisjeve ; Doganën e Republikës Kosovës; ATK-se, dhe çdo institucion tjetër në organet kompetente, deri te OSHP- për futjen e OE, ne Listën e Zeze nëse konstatohet se dokumenti zyrtar i dozuar është I falsifikuar

Andaj, kërkojmë që brenda afatit ligjor te dorëzoni dokumentet e kërkuara.

Andaj, Grupi i Operatorëve Ekonomik: NIKA PrO- Ing SH.P.K.; FUSHA,, këto dokumente duhet ti dorëzoni vetëm në formë elektronike, përmes platformës së prokurimit elektronik, deri më datë 08.04.2026 , ora 16:00.

Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i juaj do të refuzohet.

Autoriteti Kontraktues, ju ka dërguar Letrën standarde për sqarime me date: 03.04.2026 përmes e-prokurimit Grup i Operatorëve Ekonomik ; NIKA PrO- Ing SH.P.K.; FUSHA, edhe pas kërkesës me shkrim për sqarime me date: 03.04.2026, nga Autoriteti Kontraktues, nuk keni dorëzuar përgjigje brenda afatit 5 ditore të përcaktuar në njoftim.

- **Gupi i OE PRO&CO GROUP SH.P.K&EVEREST SHPK&BENI CONSTRUCTION SHPK është i papërgjegjshëm, ndërsa arsyet e eliminimit që janë dhënë nga AK-së për këtë OE janë edhe pretendime tona ankimore, prandaj për të mos i përsëritur ato ne vetëm po i shënojmë ashtu siç i ka shënuar autoriteti kontraktues.**

Komisioni i vlerësimit pas identifikimit të çmimeve jo-normalisht të ulët (jashtëzakonisht të ulëta dhe të larta), Autoriteti Kontraktues me date e 10.04.2026 ju ka kërkuar sqarime të detajuara dhe dëshmi për secilin çmim të kontestuar deri me date 15.04.2026, ora 16:00

Megjithatë, nga ana juaj është dorëzuar vetëm një deklaratë e përgjithshme me date 15.04.2026, pa ofruar sqarime konkrete dhe pa dëshmi mbështetëse për çmimet e kërkuara, për artikujt e veçuar ashtu siç është kërkuar në kërkesën për sqarim ne letrën standarde te datës te lart cekuar

Si rrjedhojë, konsiderohet se nuk keni arritur të arsyetoni çmimet e ofruara ne ofertën e dozuar me date 15.01.2025 .

Letër standarde për tenderuesin eliminuar, i bashkëngjitet:

1. Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët e datës :10.04.2026 Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K;

2. Përgjigja nga Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K, e datës 15.04.2026.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SEKRETARIATI – SEKRETARIJAT - SECRETARAIT

## Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët

**Data:10.04.2025**
**Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës**
**Rr,,Luan Haradinaj,, nr.133 Prishtinë**
**Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.**

| | |
|---|---|
| Nr[1] i prokurimit | 328-25-10922-5-1-1 |
| Nr i brendshëm | 33300/25/034/511 |

**Titulli:** Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë

I/e nderuar(a) [Z/Znj]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim " LPP ". Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ne konsiderojmë që tenderi juaj është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës.

Që të mund ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, si në vijim:

Komisioni në përbërje të plotë prej tre (3) anëtarësh, Bazuar ne Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, të LPP-së; dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurim Publik; Udhëzuesin Nr. 002/2024 për plotësim-ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik, konkretisht Nenin 40 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.
konkretisht në:

Nenin 1 – Qëllimi;

Nenin 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, ku përcaktohet se:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara të sigurojnë që fondet dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, duke marrë parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit;
2. Fondet dhe burimet publike të ofruara sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm për qëllimet e asaj kontrate
3. Dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurim Publik; Udhëzuesin Nr. 002/2024 për plotësim-ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik, Neni 4 – Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit, konkretisht pika (c) e cila kërkon që të sigurohet se çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Ka konstatuar se në listën e çmimeve të dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë: Pro & Co Group SH.P.K., EVEREST SH.P.K. dhe Beni Construction SH.P.K., kemi Ofruar disa Pozicione - Çmime Jo normalisht të Ulëta. Dhe disa Çmime shumë të Larta në Krahasim me Çmimet e Tregut në Republikën e Kosovës dhe me Krahasimin e Ofertave tjera të pranuara për këtë aktivitet te prokurimit me titull:" Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë", me numër te Prokurimit: 328-25-10922-5-1-1 dhe numri i brendshëm: 33300/25/034/511.

'Lisat e Çmimeve Numër 1.0 ARKITEKTURA, NDËRTIMTARA ETJ.

| Poz. 1 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja ( Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2 | Furnizimi me material si dhe punimi i tabelave me shënjëzimi informativ dhe të SShP (Sigurisë dhe shëndetit në punë) në përputhje me, ligjet, rregulloret si dhe udhëzimet administrative për siguri dhe shëndet në punë si dhe të dhënat për projektin, projektuesin, investitorin, punë kryesin, kompaninë mbikëqyrëse, vlerën e kontratës dhe afatin për realizimin e kontratës | Cope | 2.00 | 5.000.00€ | 10.000.00€ | Republika e Kosovës |

| Renditja Ofertat | OE | Çmimi për nejsi € | Sasia | Totali (€) | % mbi më të lirën |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 Grup Operatori Ekonomik: Grup | Oferta 5 | 5,000.00€ | 2 | 10,000.00€ | +3233.33% |

2

| Renditja Ofertat | OE | Çmimi për nejsi € | Sasia | Totali (€) | % mbi më të lirën |
|---|---|---|---|---|---|
| Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K. | | | | | |
| 2 | Oferta 4 | 3,500.00€ | 2 | 7,000.00€ | +2233.33% |
| 3 | Oferta 3 | 1,250.00€ | 2 | 2,500.00€ | +733.33% |
| 4 | Oferta 7 | 495.00€ | 2 | 990.00€ | +230.00% |
| 5 | Oferta 6 | 300.00€ | 2 | 600.00€ | +100.00% |
| 6 | Oferta 2 | 258.00€ | 2 | 516.00€ | +72.00% |
| 7 | Oferta 1 | 150.00€ | 2 | 300.00€ | 0% |

Për pozicionin e lartcekur, 1.2. çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Lartë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi **Manipulativ**, **çmimi i ofruar nga ofertat e juaj rezulton të jetë:3233.33% më i lartë se oferta më e ulët e paraqitur– E PRANUARA** .

| Poz. 1 | Përshkrimi I pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja ( Eu) | Vendi I Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.5 | Vendosja e tre kantenjerëve. Njën nga ta të pajiset me rrymë dhe ndriqim, me tri tavolina, tri karrika dhe kompjuter me kapacitet dhe programe të autocad-it dhe archicad-it etj për hapjen e projektit në teren. Në këtë kontenjer do të zhvillojë veprimtarinë Mbikëqyrësi me rastin e vizitave dhe Menagjeri konstant I ndërtimit gjatë tërë orarit të punës i caktuar nga O.E., i cili duhet të jetë me diplomë master apo Inxhinjer i diplomuar i arkitekturës ose i ndërtimarisë, me përvojë të dëshmuar së paku 10 vjeqare. Kontinjeri I dytë i dedikuar për punëtorë me tavolina dhe karrika sa numri i punëtorëve aktual, me dimensione të përshtatshme.Kontenjeri i tretë me dimensione të vogla I dedikohet rojës | Komplet | 1.00 | 30.000.00€ | 30.000.00€ | Republika e Kosovës |

Për pozicionin e lartcekur, 1.5. çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Lartë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë: 1400% më i lartë se ofertat më e ulët e paraqitur – E PRANUARA.

| Renditja Ofertat | Çmimi (€) | % më e shtrenjtë oferta e parë (30,000 €) |
|---|---|---|
| **1.Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K** | **30,000 €** | **1400%** |
| 2 | 2,000 € | 1400% |
| 3 | 2,000 € | 1400% |
| 4 | 6,000 € | 400% |
| 5 | 8,200 € | 266% |
| 6 | 12,000 € | 150% |
| 7 | 13,500 € | 122.22% |

4

| Poz. 1 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja ( Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.6 | Furnizimi dhe kryerja e punimeve me: vinç për etazhitet B+P+4 me lartësi te objektit h=25.0 m dhe sipërfaqe mbuluese të ndërtesës S=1155.0 m2, për ngritjen e materialeve nga parcela deri ne pikat e nevojshme, skele me montim profesional për muratim qarkor dhe fasadim, hilita për hapje të vrimave apo thyerje eventuale te deformimeve, së paku dy vibratorë të fuqishëm për të vibruar betonin, shpues hidraolik rrethor të betonit për hapjen e të gjitha vrimave të nevojshme në muri apo pllakë nga beton armeja etj. | Komplet | 1.00 | 50.000.00€ | 50.000.00€ | Republika e Kosovës |

| Renditja Ofertat | Çmimi (€) | % më e shtrenjtë oferta e parë (50,000 €) |
|---|---|---|
| 1. Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K | 50,000 € | 1011.11% |
| 2 | 4,500 € | 1011.11% |
| 3 | 5,000 € | 900% |
| 4 | 5,000 € | 900% |
| 5 | 12,550 € | 298.41% |
| 6 | 15,000 € | 233.33% |
| 7 | 22,500 € | 122.22% |

Për pozicionin e lartcekur, I.6. çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Lartë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë: 1011.11%, më i lartë se ofertat më e ulët e paraqitur – E PRANUARA

5

| Poz. 2 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja ( Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Poz. 2 | **2.0 PUNET E DEMOLIMIT, DHEUT DHE ZHAVORIT. Veprimet e ndërmarra paraprakisht duhet konsultuar dhe aprovuar nga arkitekti mbikëqyrës.**<br><br>**Përshkrimi i pozicionit** | | | | | |
| 2.1 | Demolimi i shumë drunjëve, shkurreve, mbeturinave të lehta dhe të rënda mbi tokë dhe ato eventuale të pa dukshme që mund të ndodhen në thellësi të tokës, katër themeleve masive me nga 10 m gjatësi nga beton armeja per bajtjen e rezervoarëve dhe rrënojave ekzistuese dhe të një ndërtese përdhese me dimensione afer 25mx10 m me mure të forta dhe të trasha . të gjitha këto në sipërfaqen e parceles S=3644.0 m2. Në çmim të kalkulohet bartja deri në destinacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktues apo në deponinë e mbeturinave të lejuar nga komuna. OBLIGATIVE: Për arsye të vlerësimit sa më të saktë të këtij pozicioni, preferohet të behet vizita në teren para ofertimit! | Komplet | 1.00 | 25.000.00€ | 25.000.00€ | Republika e Kosovës |

Për pozicionin e lartcekur, 2.1 çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm **më i Lartë** në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë: **1,666.67%**, më i lartë se ofertat më e ulët e paraqitu – E PRANUARA.

| **Renditja Ofertat** | **Çmimi (€** | **Krahasuar me bazën (%)** |
|---|---|---|
| **Oferta 1 Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.,** | **25,000.00** | **1,666.67%** |
| Oferta 2 | 1,500.00 | 100% |
| Oferta 3 | 14,500.00 | 966.67% |
| Oferta 4 | 2,100.00 | 140% |

6

| Renditja Ofertat | Çmimi (€ | Krahasuar me bazën (%) |
|---|---|---|
| Oferta 5 | 9,500.00 | 633.33% |
| Oferta 6 | 6,500.00 | 433.33% |
| Oferta 7 | 15,750.00 | 1,050% |

| Poz. 3 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja ( Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Poz. 3 | **3.0 PUNËT E BETONIT, KUJDES: Çdo mikser duhet të testohet, si konsistenca në vend dhe poshtu nga një kubëz në laborator kredibil, duke shenu datën dhe pozicionin, me shpenzime të Operatorit Ekonomik. Materialet e përdorura paraprakisht duhet aprovuar nga organi mbikëqyrës.** | | | | | |
| 3.2 | Furnizimi me beton C30/37 të atestuar, hudhja me pompë, vibrimi tejet i kujdesshëm dhe detal i tërë sasisë, me nga së paku dy vibratorë aktiv deri në largim të fluskave të ajrit dhe ujëja e tijë për pozicionin e themel pllakës, pllakave të meskateve, mureve, shtyllave, trajeve, shkallëve, atikës si në projekt. Sasia e betonit 4000 m³ * 1.05 =4200.00 m³ (për arsye të sasisë së nevojshme të furnizimit për ndonjë pozicion të paparashikuar, zvoglimit të vëllimit nga largimi i ujit dhe ajrit pas vibrimit detal, rjedhjet, mbetje nëpër miksere dhe pompë, zgjërime të kallupeve, toleranca gjatë nivelizimit të pllakave etj.) | m3 | 4200 | 300.00€ | 1.260.000.00€ | Republika e Kosovës |

Për pozicionin e lartcekur, 3.2 çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm **më i Lartë** në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, **është çmimi Manipulativ**, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë: **+ 272.73%**, më i lartë se ofertat më e ulët e paraqitur – E PRANUARA.

| Renditja Ofertat | Totali (€) | Krahasuar me bazën (%) |
|---|---|---|
| **Oferta 1 Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.;** | **1,260,000€** | **+ 272.73%** |

| Renditja Ofertat | Totali (€) | Krahasuar me bazën (%) |
|---|---|---|
| EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K., | | |
| Oferta 2 | 529,200€ | 114.55% |
| Oferta 3 | 630,000€ | 136.36% |
| Oferta 4 | 567,000€ | 122.73% |
| Oferta 5 | 567,000€ | 122.73% |
| Oferta 6 | 462,000€ | 100% |
| Oferta 7 | 510,300€ | 110.45% |

| Poz. 6 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Totali ( Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **6.0 PUNET E MURATIMIT, Obligative: Eksperti udhëheqës i ekipit duhet të jetë i trajnuar dhe qertifikuar nga prodhuesi i Knaufit.Sipërfaqjae llogaritet bruto, ku sipërfaqja e dyerve dhe dritareve nuk zbriten. Materialet e përdorura paraprakisht duhet aprovuar nga arkitekti mbikëqyrës.** | | | | | |
| 6.1 | Furnizimi me material dhe muratimi i mureve d = 25 cm, me blloqet gitar 20 x 20 x 25 cm me llaç vazhdues. Në çmim të llogaritet edhe cerklazhi përforcues me beton armo me prerje tëthore së paku 25x25cm përgjatë tërë mureve, në nivelin e mbi dritareve apo dyerve si dhe ankorimi me armaturë për shtangim anash për konstruksioni të betonit aty pranë, në çdo 50cm lartësi. | m3 | 600.00 | 40.00 € | 24,000.00 € | Republika e Kosovës |

Për pozicionin e lartcekur, 6.1 çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Ultë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë më i lire se ofertat paraqitura – E PRANUARA

| Oferta | Totali (€) | Krahasuar me bazën (%) |
|---|---|---|
| Oferta 1 Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K., | 24,000€ | 100% |
| Oferta 2 | 33,000€ | 137.50% |
| Oferta 3 | 57,000€ | 237.50% |
| Oferta 4 | 63,000€ | 262.50% |
| Oferta 5 | 57,000€ | 237.50% |
| Oferta 6 | 33,000€ | 137.50% |
| Oferta 7 | 47,520€ | 198.00% |

| Poz. 7 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Totali ( Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 7.1 | Fumizimi me material dhe suvatimi i mureve të jashtme nga ana e brendshme, mureve të brendshme nga argjila,siporeksi apo betoni, shtyllave dhe tavaneve, me llac të gatshëm gëlqeror M75 , rrjetën rabic në mes të betonit dhe blloqeve. E tërë sipërfaqja të trajtohet pastaj me gips për ratshim detal, të cilat do të kontrollohen me reflektorë nga afërsia 1.0 metërshe. Sipërfaqet e betonit duhet paraprakisht të trajtohen me lyerjen bazë- kontakt beton.Kërkohen atestet nga prodhuesi dhe certifikatat e kualitetit të klasit të parë dhe aspektit ekologjik nga institucionet e akredituara. | m2 | 11900 | 4.00 € | 47,600.00€ | Republika e Kosovës |

Për pozicionin e lartcekur, 7.1 çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Ultë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë më i lirë se ofertat e paraqitura – E PRANUARA

9

| Renditja Ofertat | Çmimi/Njësi (€) | Totali (€) | Krahasuar me më të lirën (%) |
|---|---|---|---|
| **Oferta 1 Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.,** | 4.00 | 47,600 | 100% |
| Oferta 2 | 7.00 | 83,300 | 175.00% |
| Oferta 3 | 14.50 | 172,550 | 362.50% |
| Oferta 4 | 10.00 | 119,000 | 250.00% |
| Oferta 5 | 10.00 | 119,000 | 250.00% |
| Oferta 6 | 6.50 | 77,350 | 162.50% |
| Oferta 7 | 5.50 | 65,450 | 137.50% |

| Poz. 8 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja (Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 8.5 | Furnizimi si dhe montimi i Fasades Gjysëm Strukturale (ku profilet janë të dukshme nga jashtë) nga profilet e Aluminit M4 të prodhuesit Alumil ose ngjashëm, si dhe me xham termopan 6+16+6mm i mbushur profesionalisht me argon në mes, ku xhami i jashtëm është dyshtresorë 3+3 mm me folje ngjitëse në mes si dhe ai i brendshem "LOW-E" 6 mm. Dimensioni i gjamit në shumicën e pozicioneve është rreth 150 x 320 cm, dhe mbi këtë lartësi, duhet të vendoset sendviq paneli afer t=28.0mm me ngjyrë antracid, deri tek pllaka e meskalit me kuotë totale +403.0 cm apo deri te trau në kuotën +350.0cm. Profili në dysheme duhet të mbulojë lartësinë e shtresave të dyshemesë h=12.0cm, duke përdorur profile të larta apo shtojcat të parafabrikuara nga alumini për këto lloj fasadash. Në kuadër të siperfaqes së F.Gj.St. parashihen 16 dritare me dim afër | m2 | 460 | 100.00 € | 48,000.00 € | Republika e Kosovës |

10

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 150x180cm me parapet h=90.0-100,0cm me hapje kiper nga poshtë lartë dhe dyert e hyrjeve për në objekt me 8 krahë me dim. afer 90x280 cm, me doreza të gjata 2.0m dhe amortizere hidraulik të kualitetit superior për vetmbyllje me fuqi adekuate sipas peshës së krahut. Në çmim të përfshihet letra difuzive me ngjitës vetanak përqark tërë fasadës me qëllim të mbylljes totale të ajrit dhe zërit, shkuma, tiplat etj. Kërkohen atestat nga prodhuesi dhe certifikatat e kualitetit të klasit të parë nga institucionet e akredituara. | | | | | |

| Renditja Ofertat | Çmimi/Njësi (€) | Totali (€) | Krahasuar me më të lirën (%) |
|---|---|---|---|
| **Oferta 1 Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.,** | 100.00 | 46,000 | 100% |
| Oferta 2 | 115.00 | 52,900 | 115.00% |
| Oferta 3 | 152.00 | 69,920 | 152.00% |
| Oferta 4 | 240.00 | 110,400 | 240.00% |
| Oferta 5 | 150.00 | 69,000 | 150.00% |
| Oferta 6 | 140.00 | 64,400 | 140.00% |
| Oferta 7 | 202.50 | 93,150 | 202.50% |

Për pozicionin e lartcekur. 8.5 çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i **Ultë** në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë më i lire se ofertat e paraqitura – E PRANUARA

| Poz. 11 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja ( Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|

11

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11.1 | Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë dhe cokllës qarkore h=7 cm me pllaka të mëdha nga porcelani i plotë të klasit të parë,t=0.8-1.0cm me ngjitës përkatës kualitativ në pozicionet e përcaktuara me projekt, me fuge prej 2-3 mm. Dimensionet e pllakave, ngjyra dhe tekstura të përcaktohet nga arkitekti mbikëqyrës. | m2 | 5200 | 14.00 € | 72,800.00 € | Republika e Kosovës |

| Renditja Ofertat | Çmimi/Njësi (€) | Totali (€) | Krahasuar me më të lirën (%) |
|---|---|---|---|
| **Oferta 1 Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.,** | 14.00 | 72,800 | **100%** |
| Oferta 2 | 38.00 | 197,600 | 271.43% |
| Oferta 3 | 30.00 | 156,000 | 214.29% |
| Oferta 4 | 30.00 | 156,000 | 214.29% |
| Oferta 5 | 36.00 | 187,200 | 257.14% |
| Oferta 6 | 22.00 | 114,400 | 157.14% |
| Oferta 7 | 31.30 | 162,760 | 223.57% |

Për pozicionin e lartcekur. 11.1. çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm **më i Ultë** në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë mbi: 100 %, më i lire se ofertat e paraqitura – E PRANUARA.

| Poz. 11 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja (Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11.6 | Furnizimi me material dhe punimi i pllakave të porcelanit të klasit të parë me dimensione minimale 60x120cm në muret e wc-ve, Këndet 90 shkallë në | m2 | 1020 | | | |

12

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mes të pllakave, të prehen dhe puthiten në mes veti në këndin 45 shkallë.Në çmim të llogaritet ngjitësi kualitativ,plusat,fuga dhe silikoni në këndet e mureve dhe dyshemesë.Kendet 90 shkallë në mes të pllakave, të prehen dhe puthiten në mes veti në këndin 45 shkallë.Aprovimi i dizajnit bëhet nga arkitekti mbikëqyrës. | | | 15.00 € | 15,300.00 € | Republika e Kosovës |

Për pozicionin e lartcekur. 11.6. çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Ultë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë më i lire se ofertat e paraqitura – E PRANUARA

| **Renditja Ofertat** | **Çmimi/Njësi (€)** | **Totali (€)** | **Krahasuar me më të lirën (%)** |
|---|---|---|---|
| Oferta 1 **Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.,** | **15.00** | **15,300** | **100%** |
| Oferta 2 | 40.00 | 40,800 | 266.67% |
| Oferta 3 | 32.00 | 32,640 | 213.33% |
| Oferta 4 | 40.00 | 40,800 | 266.67% |
| Oferta 5 | 36.00 | 36,720 | 240.00% |
| Oferta 6 | 25.00 | 25,500 | 166.67% |
| Oferta 7 | 27.00 | 27,540 | 180.00% |

| Poz. 12 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja (Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|

13

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12.1 | Furnizimi me material dhe montimi i tavanit të varuar Armstrong, Amf apo ngjajshëm 60x60cm me të gjitha profilet mbajtëse,varëse, fikse dhe lidhjet e nevojshme, nëpër të gjitha katet përpos në bodrum tek parkingjet. Në çmim të llogariten edhe përforcimet. Montimi të kryhet pasi të bëhet mbyllja e objektit me fasadë, përshkak të lagështisë së tepruar të atmosferës në muajtë e ftohtë. | m2 | 5300 | 10.00 € | 53.000.00 € | Republika e Kosovës |

Për pozicionin e lartcekur. 12.1. çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Ultë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë më i lire se ofertat e paraqitura – E PRANUARA

| **Renditja Ofertat** | **Çmimi/Njësi (€)** | **Totali (€)** | **Krahasuar me më të lirën (%)** |
|---|---|---|---|
| Oferta 1 **Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.,** | **10.00** | **53,000** | **100%** |
| Oferta 2 | 16.00 | 84,800 | 160.00% |
| Oferta 3 | 14.00 | 74,200 | 140.00% |
| Oferta 4 | 20.30 | 107,590 | 203.00% |
| Oferta 5 | 30.00 | 159,000 | 300.00% |
| Oferta 6 | 16.00 | 84,800 | 160.00% |
| Oferta 7 | 15.50 | 82,150 | 155.00% |

| Poz. 12 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja (Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12.2 | Furnizimi me material dhe montimi i knaufit t=12mm nëpër të gjitha katet përpos në bodrum tek parkingjet, në distancën 5 cm nën tavanin e lëshuar Armstrong, në formë të kurorës qarkore te toaletet, këthinat e vogla për | m2 | 3970 | | | |

14

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përkthyes dhe këthinat në bodrum, me gjërësi 30cm nëpër koridoret, 40 cm tek zyret, hollet e gjëra dhe sallat e vogla të gjykimit. 60 cm tek salla e konferencave, te sallat e mesme dhe të mëdha të gjykimeve. Knaufi. kapet për muri dhe për konstruksioni të amstrongut me nga dy profile "UD" t=5.0cm në drejtim gjatësor paralel me murin e ktmines. UD-ja e jashtme, nëse shihet nga jasht, ngjyroset me llak të bardhë, ndërsa me përfundimin e knaufit të dalur ancak 15 cm nga ajo, montohet profil në formë kapaku përmbylljes nga pvc-ja apo metal i zinkuar, në formë të shkronjës "U" me trashësi t=12mm. Në çmim të llogaritet finalizimi me glet dhe polikolor kualitativ. Kjo bëhet për arsye dekorative dhe shtangimi, duke krijuar kornizë të tavanit të lëshuar, dhe për ti mbuluar vizualisht skajet e tavanit nga Armstrongu, të cilat zakonisht me kalim të kohës deformohen, vjetërohen dhe zhyten. | | | 10.00 € | 39.700.00 € | R publika e Kosovës |

Për pozicionin e lartcekur. 12.2. çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Ultë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë më i lire se ofertat e paraqitura – E PRANUARA

| Renditja Ofertat | Çmimi/Njësi (€) | Totali (€) | Krahasuar me më të lirën (%) |
|---|---|---|---|
| **Oferta 1 Grup Operatori Ekonomik: Grup I Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.,** | **10.00** | **39,700** | **100%** |
| Oferta 2 | 35.00 | 138,950 | 350.00% |
| Oferta 3 | 18.00 | 71,460 | 180.00% |
| Oferta 4 | 23.50 | 93,295 | 235.00% |
| Oferta 5 | 20.00 | 79,400 | 200.00% |
| Oferta 6 | 12.00 | 47,640 | 120.00% |
| Oferta 7 | 15.50 | 61,535 | 155.00% |

15

| Poz. 16 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja ( Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16.3 | Furnizimi, instalimi dhe futja në punë e Ashensorit Elektrik do të realizohet me brende të njohura si Schindler, Thyssen-crupp, Ottis, Kleemann ose ekuivalent, me posedim të certifikata për plotësim të standardeve europiane për ashensorë siq janë EN 81-20 dhe EN 81-50 , për gjashtë ndalje-etazha (B+P+4), me lartësi të një katit l=425cm, me enterier nga lamarina e inoksit e përforcuar me panel mbrapa që pamundëson dridhjen, dysheme graniti natyral, komandë me monitor komandues me prekje, ndriqim led 4 copë, dorezë nga inoksi, pasqyrë në ballinë dhe dyer automatike rrëshqitëse nga inoksi. Me rastin e ndaljes së rrymës, të ketë ndriqim emergjent, zile, pranues të valëve telefonike dhe WF dhe me mundësinë e zbritjes në katin më të afërt dhe hapjes automatike të derës, të gjitha këto me rrymë vetanake nga bateritë vetëmbushëse. Të shfrytëzohen maksimalisht dimensionet e kthinës me mure nga beton armea e që janë me gjëresi 175cm dhe gjatësi 255 cm dhe me fuqi adekuate të motorrit për së paku 8 persona- 630 kg. Në çmim të llogaritet punimi me knauf dhe përpunimi final i murit ballor për rreth dyerve të ashensorit deri në mveshjen e plotë deri në tavan mbi te dhe në të dy anët e tijë me gjërësi zhvilluese 2 x120.0cm, me granit natyral t=1.0 cm. Në çmim të llogaritet edhe hapja e vrimës Ø 160mm në murin e beton armesë, për të lidhur pastaj me tuba të llamarinës së zinkuar Ø 160 mm, duke e furnizuar me gjatësi L=30.0m me dalje deri te grilla adekuate e furnizuar dhe vendosur te fasada e jashtme ne përdhesë, për mundësimin e ajrim te liftit nga poshtë-lartë,<br>Obligative: Eksperti udheheqës të dëshmojë se është trajnuar dhe i certifikuar nga prodhuesi ! | copë | 4.00 | 20.000 € | 80.000.00 € | Republika e Kosovës |

Për pozicionin e lartcekur. 16.3. çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Ultë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë më i lire se ofertat e paraqitura – E PRANUARA

18

| Renditja Ofertat | Çmimi/Njësi (€) | Totali (€) | Krahasuar me më të lirën (%) |
|---|---|---|---|
| **Oferta 1 Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.,** | **20,000.00** | **80,000.00** | **100%** |
| Oferta 4 | 32,500.00 | 130,000.00 | 162.50% |
| Oferta 2 | 33,000.00 | 132,000.00 | 165.00% |
| Oferta 7 | 31,208.94 | 124,835.76 | 156.04% |
| Oferta 3 | 45,000.00 | 180,000.00 | 225.00% |
| Oferta 6 | 85,000.00 | 340,000.00 | 425.00% |

| Renditja Ofertat | Çmimi/Njësi (€) | Totali (€) | Krahasuar me më të lirën (%) |
|---|---|---|---|
| **Oferta 1 Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.,** | **20,000.00** | **80,000** | **666.67%** |
| Oferta 2 | 33,000.00 | 132,000 | 1,100.00% |
| Oferta 3 | 45,000.00 | 180,000 | 1,500.00% |
| Oferta 4 | 32,500.00 | 130,000 | 1,083.33% |
| Oferta 5 | 3,000.00 | 12,000 | 100% |
| Oferta 6 | 85,000.00 | 340,000 | 2,833.33% |
| Oferta 7 | 31,208.94 | 124,835.76 | 1,040.30% |

| Poz. 16 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja ( Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16.18 | Furnizimi me material, punimi dhe instalimi me brisole alumini ngjyrë antracid në kend të pjerrët 30˚, të gjera 15cm, të distancuara gjashtë sosh në mes veti çdo 15cm, të shtirë tek pjesa e epërme e çdo kati të dritareve dhe fasadës, për arsye hijezimi, me lartësi mbuluese-hijezuese 80.0cm. Përjashtim bën e tërë përdhesa e fasadës së objektit ku nuk ka nevojë për hijezim. Llogaria bëhet me m2 mbuluese të sipërfaqes së trajtuar | m2 | 375.00 | 10.00 € | 3,750.00 € | Republika e Kosovës |

Për pozicionin e lartcekur. 16.18, çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Ultë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë më i lire se ofertat e paraqitura – E PRANUARA

| Renditja Ofertat | OE | Çmimi €/m² | Totali (€) | % mbi më të lirën |
|---|---|---|---|---|
| 1. Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K. | **Oferta 1** | **10.00** | **3,750.00** | **100%** |
| 2 | Oferta 7 | 31.50 | 11,812.50 | 215% |
| 3 | Oferta 5 | 35.00 | 13,125.00 | 250% |
| 4 | Oferta 4 | 42.00 | 15,750.00 | 320% |
| 5 | Oferta 2 | 45.00 | 16,875.00 | 350% |
| 6 | Oferta 3 | 62.00 | 23,250.00 | 520% |
| 7 | Oferta 6 | 75.00 | 28,125.00 | 650% |

| Poz. 1.1.20 | Përshkrimi i pozicionit | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja ( Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16.18 | Blerja, transporti, shtrirja, realizimi i lidhjeve dhe komisionimi i kabllos per qarqet elektrike te Fan-Coil, dhe rekuperatorët e ajrit e tipit FG7OR 3G 2,5 - 3X2,5mm² | m | 1225.00 | 6.00 € | 7,350.00 € | Republika e Kosovës |

Për pozicionin e lartcekur, 16.18, çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Ultë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë më i lirë se ofertat e paraqitura – E PRANUARA

| Renditja | OE | Çmimi €/m² | Totali (€) | % mbi më të lirën |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Oferta 6 | 75.00 | 28,125.00 | +650% |
| 2 | Oferta 3 | 62.00 | 23,250.00 | +520% |
| 3 | Oferta 2 | 45.00 | 16,875.00 | +350% |
| 4 | Oferta 4 | 42.00 | 15,750.00 | +320% |
| 5 | Oferta 5 | 35.00 | 13,125.00 | +250% |
| 6 | Oferta 7 | 31.50 | 11,812.50 | +215% |
| 7 | Oferta 1 | 10.00 | 3,750.00 | 0% |

| Poz. 1.1.20 | Përshkrimi i pozicionit - Nënstacioni termik | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja ( Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Furnizimi dhe montimi me pajisjet e jashtme ngrohëse/ftohëse AM160AXVAGH/EU<br>Heating capacity: Q=45.0 kW<br>Cooling capacity: Q=45.0 kW<br>Power Supply - Ö, V, Hz: 3 \| 380-415 \| 50<br>Power Input: 32A<br>Refrigerant: R410A<br>Operating temp. range (Heating): -25 °C | Copë | 8 | 500.00 € | 4.000.00 € | Republika e Kosovës |

Për pozicionin e lartcekur. 16.18. çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Ultë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë më i lire se ofertat e paraqitura – E PRANUARA

| Renditja Ofertat | OE | Çmimi për njësi | Totali (€) | % mbi më të lirën |
|---|---|---|---|---|
| 1. Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K., | Oferta 1 | 500.00 | 4,000.00 | 0% |
| 2 | Oferta 2 | 4,500.00 | 36,000.00 | +800% |
| 3 | Oferta 3 | 5,850.00 | 46,800.00 | +1070% |
| 4 | Oferta 4 | 8,500.00 | 68,000.00 | +1600% |
| 5 | Oferta 5 | 9,000.00 | 72,000.00 | +1700% |
| 6 | Oferta 6 | 14,500.00 | 116,000.00 | +2800% |
| 7 | Oferta 7 | 16,000.00 | 128,000.00 | +3100% |

20

| Poz. 5.1 | Përshkrimi i pozicionit<br>**SISTEMI PËR FIKJE AUTOMATIKE DHE AUTONOME TE ZJARRIT ME AEROSOL** | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja (Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.1.1 | Advanced ExGo Extinguishing Control Panel with A/M Key (GBEX-3001)<br>ExGo Paneli automatik i shuarjes me tre zona është i miratuar sipas EN12094-1 (Standardi Evropian për Sistemet Fikse të Shuarjes së Zjarrfikësve - Komponentet për Sistemet e Shuarjes me Gaz) dhe EN54 - Pjesët 2, 4 dhe 13.<br>Sistemi ExGo zbulon një zjarr në të njëjtën mënyrë si një sistem alarmi zjarri, por përveç alarmeve, ai kontrollon edhe lëshimin e një agjenti shuarës.<br>Sistemi ExGo përdoret kryesisht në zona me vlerë/rëndësi të konsiderueshme strategjike për Arkivat, duke ofruar një zgjidhje me kosto efektive për të mbrojtur nga zjarri.Ekran LCD që ofron tregues më të qartë të statusit dhe rutina programimi<br>Gjuhë të shumta<br>Softuer për shkarkimin e regjistrave të konfigurimit dhe ngjarjeve<br>Kod kalimi ose çelës opsional për akses në Nivelin 2<br>Regjistr ngjarjesh me vulë kohe dhe date dhe diagnostikim i përmirësuar<br>LCD i madh/kohëmatës dixhital me numërim mbrapsht<br>RS485 për treguesit e statusit në distancë (maksimumi 7)<br>Shkarkim nga PC nëpërmjet USB-sëTeknologji bazë Procesor i bazuar në flash<br>Ekran me ndriçim nga prapa LCD 128 x 64<br>Zona zbulimi 3 x zona konvencionale zbulimi (përfshirë mbështetjen për barrierën I.S.)<br>Zona shuarjeje 1 x zona përmbytjeje/shuarjeje. Mbështetje për aktivizuesit e tipit solenoid dhe metron | Cope | 6.00 | 450.00€ | 2.700.00 € | Republika e Kosovës |

21

Për pozicionin e lartcekur. 5.1.1. çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Ultë në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë më i lire se ofertat e paraqitura – E PRANUARA

| Renditja Ofertat | OE | Çmimi | Totali (€) | % mbi më të lirën |
|---|---|---|---|---|
| 1 Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K., | Oferta 1 | 450.00 | 2,700.00 | 0% |
| 2 | Oferta 8 | 640.00 | 3,840.00 | +42.22% |
| 3 | Oferta 7 | 690.00 | 4,140.00 | +53.33% |
| 4 | Oferta 5 | 700.00 | 4,200.00 | +55.56% |
| 5 | Oferta 2 | 1,250.00 | 7,500.00 | +177.78% |
| 6 | Oferta 6 | 2,500.00 | 15,000.00 | +455.56% |
| 7 | Oferta 3 | 6,500.00 | 39,000.00 | +1344.44% |

| Poz. 5.1 | Përshkrimi i pozicionit SISTEMI PËR FIKJE AUTOMATIKE DHE AUTONOME TE ZJARRIT ME AEROSOL | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi (Eu) | Kostoja ( Eu) | Vendi i Origjinës materialit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.1.3 | Apollo Series 65 Standard Base (45681-200 APO) Baza Standarde e Serisë Apollo 65 - 45681-200 është projektuar për të mundësuar montimin e detektorëve pa nevojën e forcës - veçanërisht e dobishme kur montohet në tavane të varura. Të gjitha bazat e Serisë 65 kanë një montim 'vetëm njëkahësh'. Detektorët mund të fiksohen në vend me një vidë ngjitëse duke përdorur një kaçavidë gjashtëkëndore 1,5 mm. Funksionimi: Të gjithë detektorët në gamën e Serisë 65 përshtaten në bazat standarde të montimit të Serisë 60. Bazat janë me diametër 100 mm dhe kanë pesë terminale të shënuara sipas funksionit të tyre: Linja 1 hyrëse, linja 1 dalëse, linja 2 hyrëse dhe dalëse, treguesi | | 58.00 | 10.00€ | 580.00 € | Republika e Kosovës |

22

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | negativ i telekomandës, tokëzimi. Detektoret janë të pandjeshëm ndaj polaritetit, kështu që identifikimi i linjave pozitive dhe negative kërkohet vetëm nëse është instaluar një LED i telekomandës. Një lidhje tokëzimi nuk kërkohet as për sigurinë dhe as për funksionimin e saktë të detektorëve. Terminali i tokëzimit është siguruar për përfundimin e rregullt të përçuesve të tokëzuar ose mjetave të kabllove dhe për të ruajtur vazhdimësinë e tokëzimit kur është e nevojshme. Bazat kanë një diametër të gjerë të brendshëm për lehtësi aksesi në kabllo dhe terminale dhe ka dy hapësira për fiksimin e vidave në një distancë prej 51 deri në 69 mm. Detektorët futen në baza vetëm në një mënyrë dhe kërkojnë rrotullim në drejtim të akrepave të orës pa forcë shtytëse për t'u lidhur. Mekanizëm kyçjeje i detektorit, montim në një mënyrë, I lehtë për t'u lidhur, përmban një lidhës tokëzimi, nuk përmban pjesë elektrike, terminal për frequesin e telekomandës | | | | | |

Për pozicionin e lartcekur. 5.1.3. çmimi i ofruar në ofertën tuaj është dukshëm më i Ulët në krahasim me ofertat e tjera të pranuara, është çmimi Manipulativ, çmimi i ofruar nga oferta e juaj rezulton të jetë më i lirë se ofertat e paraqitura – E PRANUARA

| Renditja Ofertat | OE | Çmimi | Totali (€) | % mbi më të lirën |
|---|---|---|---|---|
| 1 Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K., | Oferta 1 | 450.00 | 2,700.00 | 0% |
| 2 | Oferta 8 | 640.00 | 3,840.00 | +42.22% |
| 3 | Oferta 7 | 690.00 | 4,140.00 | +53.33% |
| 4 | Oferta 5 | 700.00 | 4,200.00 | +55.56% |
| 5 | Oferta 2 | 1,250.00 | 7,500.00 | +177.78% |
| 6 | Oferta 6 | 2,500.00 | 15,000.00 | +455.56% |
| 7 | Oferta 3 | 6,500.00 | 39,000.00 | +1344.44% |

23

Për ketë pozicione , Grup Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K., është i obliguar të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur, dhe të bashkëngjisë dëshmitë përkatëse, si në vijim:

1. Emrin e prodhuesit:
2. Pro-faturë/Faturë e furnizimit me të dhëna të sakta për furnizuesin, adresën e saktë të furnizimit dhe vlerën totale që përfshin të gjitha taksat;
3. Dëshmi mbi origjinalitetin e furnizimeve dhe burimin e artikullit të ofruar.

**Sqarim:**

Dosja e tenderit e publikuar më datë 03.12.2025, me titull: Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, Numri i Prokurimit: 328-25-10922-5-1-1 dhe numër i brendshëm:33300/25/034/511, sipas

1. Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), neni 61;
2. Dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurim Publik; Udhëzuesin Nr. 002/2024 për plotësim-ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik, neni 4 pika (C) – që përcakton se çmimi i kontraktuar nuk duhet të jetë më i lartë se çmimi i tregut, dhe nenin 41 – Tenderët jo normalisht të ulët.
3. Autoriteti Kontraktues: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka të drejtën ligjore që të verifikojë të gjitha Dëshmitë - Çmimet e paraqitura nga OE, - ose G.O.E, në institucionet kompetente, duke filluar nga: **Adresa e Furnizimit; Doganën e Republikës Kosovës; ATK-se; Organet Kompetent Hetuesisë; OSHP- për futjen e OE, - ose G.O.E. ,ne Listën e Zeze, nëse konstatohet se dokumenti zyrtar I dozuar është I falsikukuar nga OE, - ose G.O.E.**

Ju lutemi që të gjitha sqarimet dhe dokumentet e kërkuara të dorëzohen brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Deklarata dhe dëshmia e bashkëngjitur për artikullin / pozicion te lart cekur sipas numrave rendor duhet te ngarkohet ne: Platformë E- prokurim, deri **me date: 15.04.2026, ora 16:00**

Nëse nuk marrim përgjigje nga ju mbi pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të dhënë, tenderi juaj do të refuzohet.

Me respekt,

Komisioni i vlerësimit

24

## Deklaratë sqaruese

GOE: Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.
Titulli i aktivitetit të prokurimit: "Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë"
Nr. i Prokurimit: 328-25-10922-5-1-1
Nr. i Brendshëm: 33300/25/034/511

*I nderuar Autoritet Kontraktues,*

Në përgjigje të kërkesës suaj të adresuar përmes ***Letër Standarde me kërkesën për informatat,*** lidhur me sqarimin e disa çmimeve të ofruara të cilat janë cilësuar si jo-normalisht të ulëta, ju paraqesim sqarimin tonë teknik, ekonomik dhe ligjor si në vijim.

***Struktura e çmimeve në ofertën tonë është e balancuar në nivel total.*** Disa pozicione paraqiten me çmime më të larta për shkak të përfshirjes së plotë të kostove dhe përgjegjësive përkatëse, ndërsa disa të tjera janë më të ulëta si rezultat i avantazheve tona konkurruese, përfshirë kapacitetet e brendshme, furnizimin direkt dhe ekonominë e shkallës. Kjo qasje është praktikë e zakonshme dhe nuk përbën manipulim të çmimeve.

***Krahasimi me ofertat tjera*** -Sa i përket krahasimit të bërë nga ana juaj, vërejmë se ai është realizuar në mënyrë lineare dhe selektive për pozicione individuale. Megjithatë, edhe ofertat e operatorëve të tjerë ekonomik përmbajnë çmime të ndryshme në pozicione të ndryshme dhe asnjë ofertë nuk është uniforme në tërësi. Për rrjedhojë, një krahasim i kufizuar në disa pozicione nuk përfaqëson një analizë të plotë dhe objektive.

***Argumenti ligjor*** -Në aspektin ligjor, duke u bazuar në Nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik, vlerësimi i ofertës duhet të bëhet në nivel të përgjithshëm, duke marrë në konsideratë realizueshmërinë e kontratës. Pozicionet individuale nuk mund të shërbejnë si bazë për diskualifikim, përderisa oferta në tërësi është e realizueshme, e balancuar dhe konkurruese. Çdo devijim nga ky standard përbën interpretim të gabuar të ligjit dhe cenon drejtpërdrejt parimet e barazisë në trajtim dhe transparencës.

***Arsyetimi i pozicioneve*** -Çmimet e paraqitura nga ana jonë janë plotësisht të arsyetuara. Çmimet më të larta në disa pozicione janë rezultat i përfshirjes së elementeve si mobilizimi, pajisjet profesionale, stafi teknik dhe rreziku operacional, ndërsa çmimet më të ulëta reflektojnë avantazhet tona konkurruese dhe organizimin efikas të burimeve. Këto janë elemente të ligjshme të konkurrencës dhe nuk mund të interpretohen si indikacion i ofertës jo-normalisht të ulët.

***Pozicioni ynë në total***- Nga analiza e përgjithshme rezulton se oferta jonë është ndër më konkurrueset dhe ekonomikisht më të favorshmet. Edhe në rastet kur disa pozicione janë më të larta, në total ajo mbetet e balancuar dhe në përputhje me interesin publik.

***Kërkesë për sqarim mbi bazën e krahasimit***- Me qëllim të transparencës, kërkojmë sqarim lidhur me metodologjinë e përdorur për vlerësimin e çmimeve, konkretisht nëse është përdorur ndonjë

çmim referues zyrtar, nëse ekziston analizë e dokumentuar e tregut, apo nëse krahasimi është bazuar vetëm në ofertat e operatorëve ekonomik.
Theksojmë se krahasimi i thjeshtë ndërmjet ofertuesve, pa një bazë objektive tregu, nuk përmbush standardin ligjor për vlerësim dhe nuk mund të prodhojë pasoja juridike ndaj operatorit ekonomik.
Njëkohësisht, kërkojmë sqarim lidhur me natyrën e kontratës (kontratë me çmime për njësi apo me çmim total), pasi kjo çështje është thelbësore për mënyrën e interpretimit të strukturës së çmimeve dhe për vlerësimin e drejtë të ofertës.

***Referencë ndaj praktikave të mëparshme (Auditimi)***- Duke u bazuar në gjetjet e auditimit, janë evidentuar raste ku janë pranuar oferta me çmime simbolike në pozicione të caktuara, duke u vlerësuar oferta në tërësi dhe jo mbi bazë të pozicioneve individuale. Po ashtu, në raste të ngjashme janë konsideruar të pranueshme diferenca të konsiderueshme ndërmjet ofertave, përfshirë:
- deri në 10% më e ulët se oferta e dytë;
- deri në 30% më e ulët se mesatarja e ofertave;
- dhe ekzistenca e së paku tre ofertave valide si indikator i konkurrencës së tregut.

Prandaj, kërkojmë që i njëjti standard të zbatohet edhe në rastin tonë, duke siguruar trajtim të barabartë dhe konsistencë në vendimmarrje

***Praktika e Organi Shqyrtues i Prokurimit*** - Duke iu referuar praktikës së OSHPs, konkretisht Vendimit nr. 717/25, në rastet që trajtojnë çështjen e ofertave me çmim jo-normalisht të ulët, është theksuar se vlerësimi duhet të bëhet në nivel të ofertës në tërësi dhe jo mbi bazë të pozicioneve individuale. Prandaj, kërkojmë që i njëjti standard të zbatohet edhe në rastin tonë, duke siguruar trajtim të barabartë dhe konsistencë në vendimmarrje.

***Garancioni i ekzekutimit***- Theksojmë se për këtë kontratë ne ofrojmë garancion të ekzekutimit, I cili mbulon në tërësi përmbushjen e obligimeve kontraktuale dhe garanton realizimin korrekt të punimeve. Ky garancion përbën siguri të mjaftueshme për Autoritetin Kontraktues dhe mbulon çdo rrezik eventual në ekzekutimin e kontratës..

***Qëndrim për integritetin dhe paanshmërinë***- Vlerësojmë se mënyra e vlerësimit në këtë rast nuk reflekton plotësisht një analizë objektive dhe të balancuar të ofertës sonë. Fokusimi selektiv në disa pozicione ngre shqetësime lidhur me paanshmërinë, trajtimin e barabartë dhe ndikimin e mundshëm të faktorëve jo-teknikë. Çdo devijim nga parimet e transparencës dhe barazisë mund të perceptohet si cenim i konkurrencës së drejtë.

Ne si kompani me mbi 200 të punësuar, me kapacitete të dëshmuara, referenca të qëndrueshme dhe kontribut të vazhdueshëm në buxhetin e Republikës së Kosovës, presim që vlerësimi i ofertës sonë të bëhet në përputhje të plotë me ligjin dhe mbi baza objektive. Çdo vendimmarrje që bie ndesh me këto parime do të kundërshtohet përmes mjeteve juridike të parapara në legjislacionin në fuqi.

*Përfundim-* Oferta jonë është në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, është e realizueshme, konkurruese dhe në interes të buxhetit publik. Andaj, kërkojmë që vlerësimi të bëhet në nivel të ofertës në tërësi dhe në përputhje me standardet ligjore në fuqi.

Graçanicë,
Më: 15.04.2026

Kenan Emini
Pro & Co Group Sh.P.K

Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.22.04.2026, mirëpo i njëjti vendim është i paqëndrueshëm sepse në asnjë mënyrë nuk janë dhënë fakte apo dëshmi konkrete për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.
Vendimi për refuzim nuk përmban fare arsyetim por vetëm është përsëritur arsyeja e eliminimit që është dhënë në letrën standarde për tenderues të eliminuar.
Në këtë vendim ceket që rishqyrtimi nuk mund të ndryshojë vendimin dhe raportin e vlerësimit të komisionit vlerësues prej tre anëtarëve. Ky pretendim nuk ka bazë ligjore fare, pasi që vetë lejimi i paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim tregon që mund të korrigjohet njoftimi mbi vendimin por që në realitet kur ka bazë ligjore për ndryshim sikurse në këtë rast duhet pasur vullnet të plotë për të korrigjuar veprimet dhe vendimet paraprake.
Sa i përket dëshmive në lidhje me vlerën e formularëve dhe deklaratave tatimore të ATK-së për liderin, e kemi sqaruar edhe më lartë se në këta formularë vlerat dhe qarkullimet janë pa TVSH, ndërsa më lartë i kemi elaboruar edhe vlerat e TVSH në detaje për secilin vit, e ku nga këto vlera kuptohet qartë se lideri i grupit e tejkalon 60% e vlerës prej 10,000,000.00 €.
Në dosje të tenderit nuk ka qenë ndonjë kërkesë specifike që qarkullimi të ofrohet pa TVSh por është kërkuar vetëm qarkullimi financiar, prandaj nuk mund të eliminohemi ne nga ky aktivitet i prokurimit sepse ky veprim bie në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjatë vlerësimit të tenderëve nuk janë marr parasysh dëshmitë relevante dhe nuk është trajtuar oferta jonë në përputhje më kërkesat e dosjes së tenderit, prandaj nuk është respektuar edhe neni 68 i LPP-së në lidhje me kapacitetin ekonomiko financiar.

Gjithashtu nuk e është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse ne jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në

mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

**VENDIM**

I. **APROVOHET**, e bazuar ankesa e grupit të OE **"EBK" SH.P.K&ULEZA NDERTIM SHPK.**
II. **ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**
III. **DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 6,000.00 euro.

## v10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*